



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura VI**  
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-015  
Prishtinë, më 22 janar 2018, në orën 9:00  
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

**PROCESVERBAL**

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 22 JANAR 2018

**Në mbledhje morën pjesë:** Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Kujtim Shala, Slavko Simiq dhe Mufera Shinik, nënkryetarë të Kuvendit.

**Nga grupet parlamentare:** Glauk Konjufca, Avdullah Hoti, Memli Krasniqi, Ahmet Isufi, Bilall Sherifi dhe Albert Kinolli.

**Në mbledhje ishin të pranishëm:**

**Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit:** Blerand Stavileci, Valmir Klaiqi dhe Avni Bytyqi.

**Nga Administrata e Kuvendit:** Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

**Nga Ambasada Amerikane:** Adem Gashi dhe Emma Lomax,

**Nga EUSR-ja:** Blerta Bejtullahu,

**Nga OSBE-ja:** Sanije Berisha,

**Nga NDI-ja:** Shefki Kastrati,

**Nga KDI-ja:** Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe katër (4) pika shtesë, të cilat i miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

#### Rend dite

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme,
2. Vazhdimi i seancës plenare, e filluar më 14 dhjetor 2017,
3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës dhe
4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

#### **1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e mëparshme e Kryesisë së Kuvendit**

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 5, 7, 12, 20, 21 dhe 22 dhjetor 2017.

#### **2. Vazhdimi i seancës plenare, e filluar më 14 dhjetor 2017**

Kryesia, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që vazhdimi i seancës plenare të Kuvendit, me pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e filluar më 14 dhjetor 2017, të mbahet të enjten, më 25 janar 2018, në orën 10:00, me këtë:

#### Rend dite

1. *Votimi i raportit të Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2016,*
2. *Shqyrtimi i eaportit vjetor të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për vitin 2016,*
3. *Shqyrtimi i kërkesës së Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për miratimin e taksave vjetore për vitin 2018,*
4. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,*
5. *Formimi i Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për një (1) anëtar të Bordit për Ankesa.*

### **3. Përgatitjet për seancën plenare të radhës**

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet për seancë plenare, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Seanca plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 25 janar 2018, në orën 14:00, me këtë:

#### **Rend dite**

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
- 4. Interpelanca e kryeministrit Ramush Haradinaj, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, për ta informuar Kuvendin në lidhje me gjuajtjen me armë nga z. Dardan Gashi, zëvendëskryeministër dhe ministër i Diasporës dhe Investimeve Strategjike,*
- 5. Shqyrtimi i propozim-Rezolutës për miratimin e objektivave për zhvillim të qëndrueshëm - Agjenda 2030 për Kosovën,*
- 6. Shqyrtimi i parë i Projekt-Kodit të Drejtësisë për të Mitur,*
- 7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike,*
- 8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,*
- 9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje,*
- 10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin nr. 04/L-115 dhe Ligjin 05/L-080,*
- 11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për azil,*
- 12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për standardizim,*
- 13. Shqyrtimi i raportit vjetor të Autoritetit Rregullator të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2016,*
- 14. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin 2016,*
- 15. Shqyrtimi i Strategjisë së Energjisë të Republikës së Kosovës, 2017-2026,*
- 16. Zgjedhja e një (1) kandidati për anëtar joekzekutiv të Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës,*
- 17. Zgjedhja e 5 (pesë) zëvendësve të Avokatit të Popullit,*

*18. Propozimi i grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve në komisione parlamentare,*

*19. Propozimi për emërimin e tre (3) anëtarëve në Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim.*

\* \* \*

Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, z. Avdullah Hoti, propozoi që në këtë seancë të radhitet në rend dite edhe Debati parlamentar lidhur me takimin IV të përbashkët të Komisionit Parlamentar të MSA-së, të mbajtur në Strasburg (Francë), prej 17-19 janar 2018.

Lidhur me propozimin e lartcekur të z. Hoti diskutuan: nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala, Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së, Bilall Sherifi, në emër të GP “Nisma për Kosovën”, Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së dhe Avdullah Hoti, në emër të GP të LDK-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, kryetari konstatoi se nuk ka informatë zyrtare nga delegacioni, mbi bazën e të cilit mund të zhvillohet debati. Debat parlamentar lidhur me këtë çështje mund të mbahen në ndonjë seancë tjetër të radhës.

#### **4. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave**

##### *1. Programi Legjislativ i Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2018*

Kryesia, pasi e shqyrtoi Programin Legjislativ të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2018, nxori këtë:

#### **P Ë R F U N D I M**

1. Programi Legjislativ i Qeverisë së Kosovës për vitin 2018 t’u shpërndahet deputetëve të Kuvendit.

2. Ngarkohen komisionet parlamentare që, mbi bazën e Programit Legjislativ të Qeverisë së Kosovës për vitin 2018 dhe të propozimeve të veta, t’i hartojnë planet e punës periodike dhe programin e punës së komisioneve për vitin 2018, deri më 31. 1. 2018.

3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme për Çështje Ligjore dhe Procedurale që në bazë Programit Legjislativ të Qeverisë së Kosovës dhe planeve të punës së komisioneve parlamentare ta hartojë Propozim-Programin e Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2018, deri më 5. 2. 2018, i cili me propozim të Kryesisë së Kuvendit i procedohet seancës plenare për miratim.

*2. Shqyrtimi i raportit të shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për nëntëmujorin e vitit 2017*

Kryesia, pasi e shqyrtoi raportin e shpenzimeve të Kuvendit për nëntëmujorin e vitit 2017, mori këtë:

V E N D I M

Miratohet raporti i shpenzimeve të Kuvendit të Republikës së Kosovës për nëntëmujorin e vitit 2017, sipas pasqyrave të paraqitura nga Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe Administrata e Kuvendit.

*3. Kërkesa e Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje” për debat parlamentar lidhur me dënimin e disa aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”*

*4. Kërkesa e nënkryetarit të Kuvendit, z. Kujtim Shala, dhe gjashtë (6) deputetëve nënshkrues për debat parlamentar lidhur me raportin e 100 ditëve të punës së Qeverisë të Republikës së Kosovës*

Kryetari i njoftoi të pranishmit me përmbajtjen e kërkesave të lartshënuara.

Lidhur me kërkesat e grupeve parlamentare të LVV-së dhe të LDK-së për debate parlamentare, diskutuan: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti dhe Kujtim Shala, nënkryetarë të Kuvendit, si dhe Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesia, pas diskutimeve, me pëlqimin e parashtrueseve të kërkesave, vendosi që këto pika të radhiten në rend të ditës të seancës tjetër të radhës.

*5. Rekomandimet e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione në lidhje me faturimin e energjisë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Republikës së Kosovës*

Kryesia, vendosi që rekomandimi i lartcekur të radhitet në rend të ditës të seancës tjetër të radhës.

*6. Procedimi i Projektligjit për shfuqizimin e Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar*

Kryetari i njoftoi të pranishmit se kërkesa e 43 deputetëve për shfuqizimin e Ligjit Nr.05/L-053 të Dhomave të Specializuara, Zyra e Prokurorit të Specializuar ka qenë në rend dite të mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit më 22 dhjetor 2017, por për mungesë të kuorumit projektligji nuk i është proceduar për mendim në Qeveri.

Pas këtij njoftimi, nënkryetari i Kuvendit, z. Kujtim Shala, dhe kryetari i GP të LDK-së, z. Avdullah Hoti, e lëshuan mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit.

Në vazhdim, kryetari e hapi diskutimin lidhur me procedimin e këtij projektligji. Lidhur me procedimin e Projektligjit për shfuqizimin e Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, diskutuan: kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti, Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së, Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së, Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së dhe Bilall Sherifi, në emër të GP “Nisma për Kosovën”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas diskutimeve, Kryesia lidhur me Projektligjin për shfuqizimin e Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, nxori këtë:

#### P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legjislative “Projektligji për shfuqizimin e Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar”, të propozuar nga 43 deputetë të Kuvendit, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afat prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

*7. Procedimi i Projektligjit për miniera dhe minerale, i hartuar nga Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e Projektligjit për miniera dhe minerale, nxori këtë:

#### P Ë R F U N D I M

1. Projektligji për miniera dhe minerale t’u shpërndahet deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

2. Ngarkohet Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, si komision funksional, që ta shqyrtojë Projektligjin në parim dhe Kuvendit t’ia paraqesë raportin me rekomandime, para shqyrtimit të parë në seancë plenare.

*8. Nisma legjislative e Projektligjit për amnistinë, i hartuar nga kryetari i GP të AAK-së, Ahmet Isufi, i mbështetur edhe nga 10 deputetë të tjerë*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e nismës legjislative për Projektligjin për amnistinë, nxori këtë:

## P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legjislative “Projektligji për amnistinë”, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afat prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

*9. Nisma legjislative e Projektligjit për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i hartuar nga Komisioni për Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e nismës legjislative për Projektligjin për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nxori këtë:

## P Ë R F U N D I M

Kërkohej nga Qeveria e Republikës së Kosovës që të paraqesë mendim lidhur me nismën legjislative “Projektligji për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës”, si dhe të përgatisë Deklaratën e ndikimit buxhetor dhe Deklaratën për përafrim me legjislacionin e BE-së të këtij projektligji në afat prej një (1) muaji nga dita e pranimit.

*10. Kërkesa e Organizatës së Veteranëve të Luftës së UÇK-së, Shoqatës së Invalidëve të Luftës së UÇK-së dhe Shoqatës së Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së për seancë të jashtëzakonshme*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me peticionin e qytetarëve për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, nxori këtë:

## P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione që ta shqyrtojë Peticionin e qytetarëve për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar.

*11. Propozimi për emërimin e tre (3) anëtarëve në Komisionin për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim*

Kryesia propozimin e lartcekur e radhiti në rend të ditës të seancës plenare më 25 janar 2018.

*12. Kërkesa e delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për kompensimin e shpenzimeve lidhur me pjesëmarrjen në mbledhjen IV të Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim në Strasburg*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e Delegacionit të Kuvendit të Republikës së Kosovës për kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit zyrtar të realizuar në Strasburg (Francë), mori këtë:

#### V E N D I M

1. Anëtarëve të delegacionit në Komisionin Parlamentar për Stabilizim-Asociim BE-Kosovë: Memli Krasniqi, Time Kadrijaj, Elmi Reçica, Blerta Deliu-Kodra, Vjosa Osmani-Sadriu, Armend Zemaj, Arben Gashi, Visar Ymeri, Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi, Bilall Sherifi, Danush Ademi dhe Adem Hoxha u lejohet kompensimi i shpenzimeve të udhëtimit, akomodimit (me tejkalim të shpenzimeve në bazë të rezervimeve paraprake), mëditjet dhe për darka eventuale të shtruara gjatë takimeve me anëtarët e Parlamentit Evropian lidhur me udhëtimin zyrtar të realizuar në Strasburg (Francë), prej 17-19 janar 2018.

*13. Kërkesa e deputetëve Haxhi Shala dhe Ganimete Musliu për kompensimin e shpenzimeve për udhëtimin e realizuar në Tiranë, prej 19-22 dhjetor 2017*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e deputetëve të Kuvendit, Haxhi Shala dhe Ganimete Musliu, për mbulimin e shpenzimeve udhëtimit zyrtar në Tiranë (Shqipëri), mori këtë:

#### V E N D I M

Deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Haxhi Shala dhe Ganimete Musliu, u lejohet mbulimi i shpenzimeve të udhëtimit, akomodimit, qëndrimit dhe mëditjet nga Buxheti i Kuvendit, për udhëtimin zyrtar të realizuar në Tiranë (Shqipëri), prej 19-22 dhjetor 2017.

*14. Kërkesa e deputetëve Emilija Rexhepi dhe Nezir Çoçaj për sigurimin e një zyre në Kuvend*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e deputetëve Emilija Rexhepi dhe Nezir Çoçaj, nxori këtë:

#### P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Administrata e Kuvendit që t'i shikojë mundësitë e caktimit të një zyre në ndërtesën e Kuvendit për deputetët Emilija Rexhepi dhe Nezir Çoçaj, për kryerjen e aktiviteteve të tyre zyrtare.



*15. Kërkesa e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut për mbështetje financiare*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut për mbështetje financiare, mori këtë:

V E N D I M

1. Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut mbështetet financiarisht në shumën prej 4 900€ për zhvillimin e aktiviteteve të tij.

2. Mjetet e parapara në pikën një (1) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere dhe transferohen në xhirrollogarinë bankare të Këshillit për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut.

*16. Raporti i delegacionit të Kuvendit të Kosovës lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Romë (Itali)*

Kryesia u njoftua me shkrim nga delegacioni i Kuvendit të Kosovës në Asamblenë Parlamentare të NATO-s lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Romë (Itali) prej 23-24 nëntor 2017.

**Pikat shtesë:**

*1. Propozimi i Grupit Parlamentar të AAK-së për zëvendësimin e anëtarëve në Komisionet Parlamentare*

Kryesia e radhiti propozimin e lartcekur në rend të ditës për seancën plenare të radhës, më 25 janar 2018.

*2. Njoftimi i Grupit Parlamentar të AAK-së për caktimin e deputetes Teuta Haxhiu zëvendëskryetare e këtij grupi parlamentar*

Kryesia u njoftua me shkrim nga Grupi Parlamentar i AAK-së për caktimin e deputetes, Teuta Haxhiu zëvendëskryetare e këtij grupi parlamentar.

*3. Kërkesa e organizatës joqeveritare “Ballkan Smile” për mbështetje financiare*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e OJQ-së “Ballkan Smile” për mbështetje financiare, mori këtë:

## V E N D I M

1. Organizata joqeveritare “Ballkan Smile” mbështetet financiarisht në shumën prej 3 000€ (tremijë) për subvencionimin e projektit “Demokracia shumetnike”.

2. Mjetet e parapara në pikën një (1) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere dhe transferohen në xhirollogarinë bankare të OJQ-së “Ballkan Smile”.

### *4. Kërkesa e organizatës joqeveritare “ETIKA” për mbështetje financiare*

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e OJQ-së “ETIKA” për mbështetje financiare, mori këtë:

## V E N D I M

1. Organizata joqeveritare “ETIKA” mbështetet financiarisht në shumën prej 4 000€ (katërmijë) për subvencionimin e projektit “Rinia në veprim”.

2. Mjetet e parapara në pikën një (1) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere dhe transferohen në xhirollogarinë bankare të OJQ-së “ETIKA”.

\* \* \*

Në fund, Kryesia, me qëllim të shqyrtimit të parashtrësave që janë të gatshme për seancë plenare, me propozimin e kryetarit të Kuvendit, z. Kadri Veseli, mori këtë:

## V E N D I M

1. Ndërpriten të gjitha udhëtimet zyrtare jashtë vendit të deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës prej 22 janar deri më 20 shkurt 2018.

2. Të njoftohen të gjithë deputetët e Kuvendit me këtë vendim.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 10:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit

**Kadri VESELI**

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale*